



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Projekt

LIGJ

Nr.____, datë____.____.2018

PËR

DISA SHTESA DHE NDRYSHIME

NË LIGJIN NR. 9863, DATË 28.1.2008 “PËR USHQIMIN”, I NDRYSHUAR⁽¹⁾

Në mbështetje të neneve, 78, 81 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozim të Këshillit të Ministrave

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9863, datë 28.1.2008 “Për Ushqimin”, i ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në të gjithë ligjin, emërtimi “Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit” zëvendësohet me emërtimin “Ministri” dhe fjalët “nxirret në treg” zëvendësohen me fjalët “vendoset në treg”.

¹ Ky ligj është përafuar pjesërisht me:

Rregullorja nr. 178/2002/EC e Parlamentit Europian dhe Këshillit e 28 Janar 2002 parimet e përgjithshme dhe kërkesat e ligjit të ushqimit, krijimi i Autoritetit Europian të Sigurisë Ushqimore dhe nxjerrja e procedurave të çeshtjet e sigurisë ushqimore, CELEX 2002R0178;

Rregullorja nr. 852/2004/EC e Parlamentit Europian dhe Këshillit e 29 Prill 2004 mbi higjienën ushqimore; CELEX 2004R0852.

Rregullorja 853/2004/EC e Parlamentit Europian dhe Këshillit e 29 Prill 2004 mbi rregullat specifike të higjienës së produkteve ushqimore; CELEX 2004R0853.

Rregullorja nr. 882/2004/EC e Parlamentit Europian dhe Këshillit e 29 Prill 2004 mbi kontrollin zyrtar të kryer për të verifikuar përpuethshmërinë me ushqimin dhe ushqimin për kafshë, shëndetin dhe mirëqënien e kafshëve.

Neni 2

1. Në nenin 3 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1.1. Në fillim të nenit fjalët “Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime” zëvendësohet me fjalët “Për qëllimin e këtij ligji, shprehjet e mëposhtme kanë këto kuptime”.

1.2. Pika 1, paragrafi i dytë ndryshohet si më poshtë:

“ Termi “Ushqim” përfshin pijet, çamçakëzin dhe çdo lëndë, përfshirë ujin, që në mënyrë të qëllimshme bëhet pjesë e ushqimit gjatë prodhimit, përgatitjes ose trajtimit të tij. Ai përfshin ujin pas pikës së respektimit të kritereve të cilësisë së ujit të pijshëm siç përcaktohet në pikën 54 të këtij neni”.

1.3. Në pikën 1, paragrafi i katërt, shkronja “b” ndryshohet si më poshtë:

“b) Kafshët e gjalla, përveçse kur janë përgatitur për t’u vendosur në treg për konsum njerëzor.”

1.4. Në pikën 1, paragrafi i nëntë, shkronja “e” ndryshohet si më poshtë:

“e) substancat narkotike dhe psikotrope në kuptimin e Konventës së Vetme të Kombeve të Bashkuara në Ilaçet Narkotike, 1961, dhe Konventës së Kombeve të Bashkuara në Substancat Psikotrope, 1971. ”

1.5. Në pikën 7, fjala "Shitje" zëvendësohet me fjalën “Tregtim”.

1.6. Pika 21 ndryshohet si më poshtë:

“21. “Higjiena e ushqimit” janë mënyrat, masat dhe kushtet e nevojshme për kontrollin e dëmtuesve dhe për të siguruar përshtatshmërinë për konsum njerëzor të ushqimit duke patur parasysh qëllimin e përdorimit të tij.

1.7. Pas pikës 37, shtohen pikat 38-55 si më poshtë:

“38. “Monitorim” është kryerja sistematike e një serie të planifikuar vëzhgimesh ose matjesh me qëllim për të patur një panoramë të gjendjes së përputhshmërisë me kërkesat e ligjit të ushqimit;

39. “Mbikqyrje” është një vëzhgim sistematik i një ose më shumë operatorëve të biznesit të ushqimit dhe ushqimit për kafshë ose aktivitetit të tyre;

40. “Auditim” është një shqyrtim sistematik dhe i pavarur për të përcaktuar nëse veprimet dhe rezultatet e tyre përputhen me masat e planifikuara dhe nëse këto masa janë zbatuar në mënyrë efektive dhe janë të përshtatshme për arritjen e objektivave.

41. “Verifikim” është kontrolli, nëpërmjet shqyrtimit dhe marrjes në konsideratë të provave objektive, nëse kërkesat e specifikuara janë plotësuar;

42. “Inspektim” është kontrolli i çdo aspekti të ushqimit dhe ushqimit për kafshë, i stabilimenteve dhe veprimtarisë së operatorëve të biznesit të ushqimit dhe ushqimit për kafshë për të verifikuar përputhjen me këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi;

43. “Marrja e mostrave për analizë” është marrja e ushqimit ose ushqimit për kafshë ose çdo substance tjetër, përfshirë edhe ambientin të lidhur me prodhimin, përpunimin dhe shpërndarjen e ushqimit ose ushqimit për kafshë për të verifikuar nëpërmjet analizave përputhjen me legjislacionin në fuqi;

44. “Pikë Inspektimi Kufitar” është çdo pikë sipas përcaktimeve të Pikave të Kalimit Kufitar ku lejohen të kalojnë mallra dhe ku kryhen kontrole për ushqimet dhe ushqimeve për kafshë që mbërrijnë në kufirin e territorit të Republikës së Shqipërisë.

45. “Produkt me origjinë shtazore” është mish, pjesë të trupit të kafshëve, gjaku, qumështi, vezët, mjalti e produktet e tjera nga bleta, gjarpërinjtë, bretkocat, midhjet, molusqet bivalvoret dhe

prodhimet e tjera të detit të gjalla apo pjesë të tyre, që përdoren për konsum njerëzor, çdo kafshë tjetër që përgatitet për t'u shërbyer e gjallë tek konsumatori i fundit si dhe çdo ushqim që i përmban ato në formë të papërpunuar, gjysmë të përpunuar apo të përpunuar;

46. “Çertifikatë e shëndetit” është dokumenti zyrtar në formë të shkruar, elektronike ose në një mënyrë ekuivalente që vërteton përputhshmërinë e ushqimit dhe ushqimit për kafshë me legjislacionin ushqimor në fuqi në Republikën e Shqipërisë;

47. “Bllokim” është procedura nëpërmjet së cilës organi i kontrollit zyrtar siguron që ushqimi apo ushqimi për kafshë nuk lëvizet apo tjetërsohet në pritje të një vendimi përfundimtar për destinacionin e tij. Bllokimi përfshin edhe magazinimin dhe mbajtjen në ruajtje nga vetë operatori i biznesit të ushqimit apo ushqimit për kafshë, sipas udhëzimeve të dhëna nga organi i kontrollit zyrtar;

48. “Ligji i inspektimit” është ligji nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”;

49. “Ministria” është Ministria përgjegjëse për ushqimin;

50. “Ministri” është Ministri përgjegjës për ushqimin;

51. “Autoriteti kompetent qëndror” është drejtoria përgjegjëse për sigurinë ushqimore në ministri;

52. “Autoriteti kompetent përgjegjës për kontrollin zyrtar” është Autoriteti Kombëtar i Ushqimit;

53. “Autoriteti kompetent përgjegjës për PIK” është Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, përgjegjës për administrimin dhe kontrollin në PIK të ushqimit dhe ushqimit për kafshë sipas këtij ligji;

54. Pika e respektimit të kriterëve të cilësisë së ujit të pijshëm, është pika ku duhet të respektohen vlerat parametrike të ujit të pijshëm, konkretisht:

a) për ujin e furnizuar nëpërmjet një rrjeti shpërndarjeje, pika ku uji rrjedh nga rubineti i konsumatorit;

b) për ujin e furnizuar nga një pus individual apo kolektiv, depozitë, rezervuar privat apo publik, fiks apo i lëvizshëm, pika ku ai i ofrohet konsumatorit;

c) për ujin e ambalazhuar në shishe ose në enë për përdorim nga njerëzit, pika ku uji ambalazhohet dhe në fazën e tregtimit apo të vënies në dispozicion për përdorim;

d) për ujin e përdorur në ndërmarrjet e industrisë ushqimore, pika ku uji përdoret në ndërmarrje”.

Neni 3

Neni 4 ndryshon si më poshtë:

“Neni 4

Analiza e riskut

1. Marrja e masave të përgjithshme, e masave të veçanta si dhe ushtrimi i kontrollit zyrtar për arritjen e qëllimit të këtij ligji, bazohet në analizën e riskut, përveçse kur kjo është e papërshtatshme për shkak të rrethanave apo natyrës së masës.

2. Analiza e riskut përfshin procesin e vlerësimit, komunikimit dhe menaxhimit të riskut.”

Neni 4

Pas neni 4, shtohet neni 4/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 4/1
Vlerësimi i riskut

1. Vlerësimi i riskut bazohet në provat dhe rezultatet shkencore të disponueshme dhe të marra në mënyrë të pavarur, objektive dhe transparente.
2. Vlerësimi i riskut sipas pikat 1 të këtij neni, kryhet nga Komiteti Shkencor i Vlerësimit të Riskut dhe panelet shkencore. Koordinimi i procesit të vlerësimit të riskut bëhet nga ministria.

Neni 5

Neni 5, ndryshon si vijon:

“Neni 5
Komunikimi i riskut

1. Komunikimi i riskut siguron shkëmbimin e ndërsjelltë të informacionit dhe të vlerësimit mbi dëmtuesit, risqet, faktorët e lidhur me riskun dhe perceptimin e tij, gjatë gjithë procesit të analizës të riskut.
2. Çdo institucion shtetëror detyrohet t’i japë Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (AKU), informacion lidhur me riskun sipas pikës 1 të këtij neni, si dhe me kërkesë të AKU-së, të bashkëpunojë për analizën e riskut. AKU krijon dhe drejton sistemin e informimit të shpejtë në lidhje me riskun.
3. Informacioni lidhur me riskun përcillet nga AKU në ministri. Ky informacion i përcillet Ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë dhe institucionit për shëndetin publik sa herë të kërkohet nga këto institucione.
4. Komunikimi i riskut tek konsumatorët kryhet nga Ministria, e cila është përgjegjëse për shkëmbimin e informacionit dhe komunikimin me institucionet e tjera edhe me strukturat homologe të shteteve të tjera apo organizatat ndërkombëtare.

Neni 6

Neni 6, ndryshohet si më poshtë:

“Neni 6
Menaxhimi i riskut

1. Marrja e masave për menaxhimin e riskut bazohet në rezultatet e vlerësimit të riskut dhe në parimin e parandalimit sipas nenit 7, të këtij ligji.
2. Menaxhimi i riskut kryhet nga:
 - a) Ministria, nëpërmjet propozimit rast pas rasti të akteve ligjore dhe nënligjore, miratimit të akteve nga Ministri apo marrjes së masave të tjera të përgjithëshme sipas përcaktimit të nenit 48 të këtij ligji;

b) AKU nëpërmjet zbatimit të masave të miratuara sipas shkronjës “a” të kësaj pike, kryerjes së kontrollit zyrtar dhe marrjes së masave të posaçme sipas këtij ligji.

Neni 7

Neni 8, ndryshohet si më poshtë:

“Neni 8

Parimi i transparencës

1. Ministria dhe AKU, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet përfaqësuesve të konsumatorëve dhe/ose të grupeve të interesit, gjatë përgatitjes, vlerësimit dhe rishikimit të masave të menaxhimit të riskut, kryen këshillim publik të hapur dhe transparent, me përjashtim të rasteve të pamundësisë për shkak të emergjencës.

2. Kur ka dyshime të arsyeshme se ushqimi ose ushqimi për kafshë mund të paraqesë një rrezik për shëndetin e njerëzve ose të kafshëve në varësi të natyrës, kategorizimin e shkallës së këtij rreziku, Ministria informon publikun për natyrën e rrezikut.

3. Informacioni sipas pikës 2 të këtij neni, përfshin identifikimin e ushqimit ose ushqimit për kafshë, rrezikun që ai mund të paraqesë, si dhe masat e marra ose që mund të merren për të parandaluar, zvogëluar ose zhdukur këtë rrezik.”

Neni 8

Neni 16, ndryshohet si më poshtë:

“Neni 16

Kontrolli i ushqimeve në pikat e inspektimit kufitar

1. Kontrolli zyrtar i ushqimeve që importohen, eksportohen apo kalojnë tranzit ndërkombëtar në territorin e Republikës së Shqipërisë, kryhet në pikat e inspektimit kufitar (PIK) nga inspektori i PIK-ut. Kontrolli i ngarkesave të ushqimit me origjinë shtazore në PIK kryhet nga inspektori veterinar i PIK-ut. Operatori i biznesit ushqimor njofton PIK përpara mbërritjes së ngarkesës për kohën e mbërritjes dhe natyrën e ngarkesës.

2. Në rast dyshimi për mospërputhje apo nëse ka dyshime mbi identitetin ose destinacionin e vërtetë të ngarkesës, apo mbi përputhjen midis dërgesës dhe garancive të vërtetuara, inspektori në PIK kryen kontrole zyrtare për të konfirmuar apo eliminuar dyshimet. Inspektori në PIK ndalon zyrtarisht dërgesën në fjalë deri në përfundim të rezultateve të kontrollit zyrtar.

3. Në rast se çmohet që ngarkesa nuk është në përputhje me kërkesat e detyrueshme sipas legjislacionit ushqimor apo atij veterinar, ngarkesa ndalohet të importohet, tranzitohet apo eksportohet.

a) AKU do të lejojë rishpërndarjen e ngarkesave vetëm nëse:

- i. është rënë dakort për destinacionin, me operatorët e biznesit të ushqimeve për kafshë dhe për njerëz, përgjegjës për ngarkesat;

- ii. operatorët e biznesit të ushqimeve për kafshët e për njerëzit kanë informuar autoritetet kompetente të vendit tjetër nga ka ardhur ngarkesa apo të vendit ku do të shkojë, nëse ndryshojnë, mbi arsyet dhe rrethanat që pengojnë hedhjen në treg të ushqimit në fjalë për njerëz apo për kafshë brenda territorit shqiptar;
- iii. kur vendi i tjetër i destinacionit nuk është vendi i origjinës, autoriteti kompetent i vendit tjetër të destinacionit kanë njoftuar AKU-në për gatishmërinë në lidhje me pranimin e kësaj dërgese.

b) Kur rezultatet e kontrolleve zyrtare nuk pengojnë, rishpërndarja do të kryhet jo më shumë se 60 ditë pas ditës kur AKU vendos destinacionin e dërgesës, përveç rasteve kur janë ndërmarrë veprime ligjore. Nëse, pas përfundimit të afatit prej 60 ditësh, rishpërndarja nuk është kryer, dërgesa do të asgjësohet.

c) AKU njofton ministrinë dhe zyrën doganore kufitare për masat e marra.

4. Nëse ngarkesa e importuar është në përputhje me kërkesat e detyrueshme të legjislacionit ushqimor apo atij veterinar, inspektori i PIK lëshon dokumentacionin përkatës të pranimit. Ngarkesa mund të transportohet brenda territorit të vendit apo të vendoset në treg, vetëm nëse përmban vërtetimin e pranimit. Procedura për lëshimin dhe forma e vërtetimit të pranimit miratohet me urdhër të Ministrit.

5. Ngarkesa e ushqimeve, për të cilën ka dyshime, duhet të mbahet në ruajtje, brenda standardeve të lejuara për tipe të ndryshme produktesh, në magazinim të përkohshëm derisa të kryhen procedura e përcaktimit të sigurisë së tyre dhe procedura doganore.

6. Autoriteti doganor bashkëpunon me inspektorin në PIK gjatë kryerjes së kontrollit zyrtar në PIK dhe kryen procedurat doganore për ngarkesat ushqimore vetëm pasi inspektori në PIK të japë vërtetimin e pranimit.

7. Shpenzimet për inspektimin e ngarkesave në PIK, përballohen nga operatori i biznesit ushqimor përgjegjës për ngarkesën. Tarifat përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit përgjegjës për financat.

8. Pikat e inspektimit kufitar për importin, eksportin apo tranzitin e ngarkesave të ushqimeve apo për tipe të veçanta ngarkesash përcaktohen me urdhër të Ministrit.

Neni 9

Neni 17 shfuqizohet.

Neni 10

Neni 18, ndryshohet si më poshtë:

“Neni 18

Dokumentacioni i importit dhe eksportit

1. Ngarkesa e ushqimit të importuar apo që tranzitohet në territorin e Republikës së Shqipërisë shoqërohet me dokumentacion që vërteton sigurinë dhe origjinën e ngarkesës të lëshuar nga autoriteti kompetent i vendit eksportues.

2. Për ushqimin me origjinë shtazore që importohet, certifikatat veterinarë të ngarkesave mund të njihen në mbështetje të marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe, të lëshuara nga autoriteti kompetent i vendit eksportues.
3. Çertifikatat shëndetësore veterinarë që shoqërojnë ngarkesat me origjinë shtazore të jenë në gjuhën shqipe dhe në gjuhën e vendit eksportues.
4. Në rast se nuk ka marrëveshje, sipas pikës 2 të këtij neni, njohja e certifikatave kryhet me urdhër të Ministrit pas dakortësisë midis autoriteteve kompetente të të dy vendeve për modelin e certifikatës që do të përdoret.
5. Ngarkesa e ushqimit që eksportohet nga Shqipëria shoqërohet me dokumentacionin, që vërteton sigurinë dhe origjinën e ngarkesës. Dokumenti i cili vërteton sigurinë e ngarkesës lëshohet nga AKU-ja dhe forma e tij miratohet me urdhër të Ministrit, pas dakortësisë midis autoriteteve kompetente të të dy vendeve.
6. Dokumentacioni që shoqëron produktet ushqimore me origjinë jo shtazore përcaktohet me urdhër të ministrit.
7. Modeli tip i certifikatave shëndetësore veterinarë miratohen me urdhër të ministrit.

Neni 11

Neni 19, ndryshohet si më poshtë:

“Neni 19

Liçencimi dhe pezullimi dhe/ose revokimi i licencës së
operatorëve dhe stabilimenteve të ushqimit

1. Veprimtaritë e parashikuara në këtë ligj dhe licencimi i këtyre veprimtarive, përfshihen në kategorinë II.1 të shtojcës së ligjit për licencat, autorizimet dhe lejet në fuqi. Në këto veprimtari nuk përfshihen prodhimi primar dhe hapësirat e lëvizëshme dhe/ose të përkohëshme.
2. Liçencimi i operatorit të biznesit ushqimor që kryen veprimtaritë e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni bëhet veçmas për çdo stabiliment dhe vetëm nëse operatori plotëson kriteret e liçencimit. Organi kompetent që vlerëson përmbushjen e këtyre kushteve është AKU.
3. AKU mund të revokojë licencën, në përputhje me pikën 1 të këtij neni në rastet kur:
 - a) gjatë kontrollit rezulton se nuk plotësohen kushtet dhe kriteret për të cilat është dhënë licenca;
 - b) ka një rrezik serioz për shëndetin publik dhe është e nevojshme e urgjente marrja e masave parandaluese;
 - c) kur rrethanat janë të tilla, që s'do të kishte kuptim apo mundësi për ripërmbushjen e kriterëve apo ndreqjen e shkeljes së detyrimeve nga titullari, brenda çdo afati të arsyeshëm pezullimi.
4. Përpara marrjes së vendimit të revokimit sipas gërmës “a” të pikës 3, AKU, si rregull, urdhëron ripërmbushjen e kriterëve apo ndreqjen e shkeljeve të detyrimeve, brenda një afati të arsyeshëm, pa pezullim të titullit dhe/ose pezullimin e titullit, për një afat të arsyeshëm, deri në zbatimin e urdhrin për ripërmbushjen e kriterëve apo ndreqjen e shkeljeve të detyrimeve.

5. AKU mund të pezullojë licencën, për një afat të arsyeshëm, kur rrethanat janë të tilla, që do të kishte kuptim apo mundësi për ripërmbyshjen e kriterëve apo ndreqjen e shkeljeve të detyrimeve nga titullari.

6. Çdo vendim për licencën përkatëse publikohet në regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve nga ministria përgjegjëse në fushën e ushqimit.

Neni 12

Neni 20, shfuqizohet.

Neni 13

Neni 25, ndryshohet si më poshtë:

Neni 25

Kërkesat për gjurmueshmërinë e ushqimeve dhe ushqimeve për kafshë

1. Operatori i biznesit ushqimor dhe ushqimit për kafshë, krijon dhe mban informacionin e nevojshëm për gjurmueshmërinë, në të gjitha fazat e prodhimit, përpunimit dhe shpërndarjes së ushqimit.

2. Informacioni i nevojshëm për gjurmueshmërinë përfshin këto të dhëna:

a) identitetin e çdo subjekti tregtar/personi juridik apo fizik nga i cili operatori i biznesit ushqimor është furnizuar me ushqim, ushqim për kafshë dhe kafshë që prodhojnë ushqim, si dhe çdo substance tjetër, të destinuar apo që pritet të bëhet pjesë e ushqimit;

b) identitetin e çdo subjekti tregtar të cilin operatori i biznesit ushqimor e ka furnizur me prodhimet e tij.

3. Operatori i biznesit ushqimor i ruan të dhënat e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni për jo më pak se gjashtë muaj deri në tre vjet në varësi të jetgjatësisë së ushqimeve dhe ushqimeve për kafshë dhe siguron që këto të dhëna t'i jepen menjëherë ministrisë dhe AKU-së me kërkesën e tyre.

4. Ushqimi i vendosur në treg ose që mund të vendoset në treg, etiketohet dhe identifikohet nëpërmjet dokumenteve dhe çdo lloj informacioni tjetër për të siguruar gjurmueshmërinë.

5. Për të siguruar gjurmueshmërinë, ushqimi dhe ushqimi për kafshë i vendosur në treg ose që mund të vendoset në treg, etiketohet sipas nenit 36 të këtij ligji si dhe identifikohet nëpërmjet dokumenteve dhe çdo lloj informacioni tjetër.

6. Kërkesat për sistemin e gjurmueshmërisë sipas llojit të operatorit apo sektorit përkatës, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave me propozim të Ministrit.

Neni 14

Pika 7 e nenit 26, ndryshohet si më poshtë:

“7. Përjashtime nga zbatimi i sistemit të vetëkontrollit, sipas pikës 1 të këtij neni, bëhen për prodhuesit e produkteve tradicionale, prodhuesit e sasive të vogla të produkteve primare që furnizojnë direkt konsumatorin e fundit ose operatorë biznesi të prodhimit dhe shitjes me pakicë direkt tek konsumatori i fundit, nëse garantohet arritja e një niveli të pranueshëm higjienik në zbatimin e sistemit të procedurave të vetëkontrollit, sipas praktikave të mira të prodhimit. Sasia e

prodhimit dhe shitjes, zona e tregtimit, kushtet dhe kriteret e miratimit të operatorëve të biznesit që përjashtohen nga zbatimi i sistemit të vetëkontrollit përcaktohet me urdhër Ministri.”

Neni 15

Pika 2 i nenit 37, shfuqizohet.

Neni 16

Neni 38, ndryshohet si më poshtë:

“Neni 38 Kontrolli zyrtar i ushqimit

1. Kontrolli zyrtar i ushqimit kryhet në të gjitha fazat e prodhimit, përpunimit dhe shpërndarjes me qëllim verifikimin e përputhshmërisë me kërkesat e detyrueshme të legjislacionit ushqimor.
2. Kontrolli zyrtar i ushqimit, në fushën e veprimit të këtij ligji, përfshin kontrollin e operatorëve të ushqimit, përdorimin e ushqimit, ruajtjen dhe magazinimin e tij, çdo proces, lëndë, substancë, aktivitet ose veprimtari, përfshirë transportin të cilave i nënshtrohet ushqimi për të arritur objektivat e këtij ligji.
3. Kontrolli zyrtar kryhet nga inspektorët e AKU-së.
4. Me përjashtim të rasteve të rregulluara me ligje të veçanta, llojet dhe normat e lejueshme lidhur me mbetjet e pesticideve dhe medikamenteve veterinare në ushqime, me përdorimin dhe pastërtinë e aditivëve ushqimorë, materialet në kontakt me ushqimin, kontaminuesit ushqimorë, enzimat, ushqimet për fëmijë, ekstraktet tretëse, ushqimet për përdorim me vlera ushqimore të caktuara, ushqimet me ngrirje të shpejtë, rrezatimet jonizuese, ujrat minerale, substancat pastruese si dhe çdo substancë që destinohet të bëhet pjesë e ushqimit apo të jetë në kontakt me të, kërkesat thelbësore që duhet të përmbushin produkte të veçanta ushqimore, rregullat specifike të etiketimit për ushqime të veçanta si dhe sëmundjet e transmetuara nga ushqimet, rregullat higjienike, sistemi i kontrollit në tregun e brendshëm, rregullat specifike për produktet ushqimore me origjinë shtazore, çertifikimi i sistemit TRACES, miratohen me udhëzim të Ministrit.

Neni 17

Neni 39, shfuqizohet.

Neni 18

Neni 40, ndryshohet si më poshtë:

“Neni 40 Planifikimi dhe procedura e kontrollit zyrtar

1. Kontrolli zyrtar kryhet në përputhje me rregullat e parashikuara në ligjin e inspektimit.
2. Kontrolli zyrtar kryhet rregullisht, në mënyrë periodike, në bazë të vlerësimit të riskut dhe, duke patur parapsysh këta faktorë:

- a) risqet e identifikuara që lidhen me ushqimin, me operatorin e biznesit ushqimor, me përdorimin e ushqimit dhe me çdo veprimtari që mund të ndikojë në sigurinë ushqimore;
 - b) historikun e operatorit të biznesit ushqimor lidhur me përputhshmërinë me kërkesat e këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij;
 - c) besueshmërinë e verifikimeve të kryera më parë nga vetë operatorin e biznesit ushqimor;
 - ç) çdo informacion, që disponohet nga AKU, për mosrespektimin e kërkesave të legjislacionit ushqimor.
3. Kontrolli zyrtar kryhet pa njoftim paraprak, me përjashtim të rasteve të auditit.
4. Programi vjetor dhe shumëvjeçar i inspektimeve në bazë të riskut si dhe mënyra e raportimit përcaktohen me urdhër të Ministrit.

Neni 19

Neni 41, ndryshohet si më poshtë:

“Neni 41

Veprimtaritë, metodat dhe teknikat e kontrollit zyrtar

1. Kontrolli zyrtar i ushqimit kryhet duke përdorur metoda dhe teknika të përshtatshme kontrolli, përfshirë: monitorimin, mbikqyrjen, verifikimin, auditimin, inspektimin, marrjen e mostrave dhe kryerjen e analizave.
2. Kontrolli zyrtar i ushqimit përfshin, veçanërisht, veprimtaritë e mëposhtme:
 - a) Inspektimin e:
 - i. Stabilimenteve të prodhuesve të produktit primar, operatorit të biznesit ushqimor duke përfshirë edhe rrethinat, godinat, pajisjet, instalimet dhe makineritë, transportin, si dhe ushqimin dhe ushqimin për kafshë;
 - ii. Lëndëve të para, ujit, përbërësve, aditivëve, shtesave teknologjike dhe substancave të tjera, të përdorura për përgatitjen dhe prodhimin e ushqimit dhe ushqimit për kafshë;
 - iii. Produkteve gjysëm të gatshme;
 - iv. Materialeve dhe artikujve në kontakt me ushqimin;
 - v. Procedurën e pastrimit, substancave pastruese dhe të mirëmbajtjes që përdoren në proceset e prodhimit;
 - vi. Etiketimit, prezantimit dhe reklamimit.
 - b) Kontrollin për përputhshmërinë me:
 - (i) rregullat për etiketimin dhe përputhshmërinë ndërmjet ushqimit dhe përmbajtjes së etiketës apo dokumentit shoqërues të tij;
 - (ii) kërkesat e këtij ligji për respektimin e origjinës për produktet me tregues gjeografik të mbrojtur dhe Treguesin “produkt ushqimor tradicional”;
 - (iii) kërkesat e sistemit të gjurmueshmërisë.
 - c) Auditin e procedurave mbi Praktikat e Mira të Prodhimit, Praktikat e Mira të Higjienës, Praktikat e Mira Bujqësore dhe HACCP;

- ç) Shqyrtimin e dokumentave dhe të dhënave të tjera të cilat mund të jenë të rëndësishme për vlerësimin dhe përputhshmërinë me kërkesat e detyrueshme sipas këtij ligji;
 - ë) Kontrollin e përputhshmërinë me këtë ligj për Ushqimet e Reja dhe OMGJ për njerëz dhe kafshë;
 - g) Çdo aktivitet tjetër që kërkohet për të siguruar përputhshmërinë me këtë ligj.
3. Procedurat e detajuara për metodat dhe teknikat e inspektimit miratohen me urdhër të Ministrit.

Neni 20

Neni 43, ndryshohet si më poshtë:

“Neni 43

Masat e posaçme urgjente në rast dyshimi

1. Gjatë kontrollit zyrtar, nëse ka një dyshim të arsyeshëm për shkelje të kërkesave të këtij ligji dhe është e nevojshme kryerja e verifikimeve të mëtejshme dokumentare apo marrja e mostrave për analizë deri në marrjen e një vendimi përfundimtar, AKU mund të marrë një apo disa nga masat urgjente me karakter të ndërmjetëm të parashikuara në nenin 43 të Ligjit për Inspektimin.
2. AKU mund të marrë këto masa urgjente:
 - a) pezullimin e përkohshëm të prodhimit;
 - b) ndalimin e vendosjes në treg të një partie ushqimi të importuar ose eksportin e saj;
 - c) bllokimin e një partie ushqimi;
 - ç) urdhërimin e operatorit të biznesit ushqimor të njoftojë konsumatorët apo publikun për rreziqet e mundshme që mund të paraqesë ushqimi apo përdorimi i tij në një mënyrë të caktuar;
 - d) pezullimin e plotë apo të pjesshëm të veprimtarisë të operatorit të biznesit ushqimor apo stabilimentit.

Neni 21

Pas nenit 43, shtohet neni 43/1:

“Neni 43/1

Masat dhe sanksionet e posaçme administrative për operatorët e biznesit ushqimor

1. Në rast të konstatimit gjatë kontrollit zyrtar, të mospërputhshmërisë me kushtet e legjislacionit ushqimor dhe veterinar, AKU merr masa ndaj operatorit të biznesit ushqimor, sipas nenit 68 të këtij ligji.
2. Nëse është e nevojshme, së bashku me dënimin përkatës, AKU urdhëron operatorin e biznesit ushqimor për marrjen e masave për korrigjimin e shkeljeve të konstatuara dhe eliminimin e pasojave të tyre brenda një afati të përcaktuar. AKU vendos gjithashtu edhe pezullimin e liçencës apo një nga masat e posaçme sipas nenit 43 të këtij ligji, deri në korrigjimin e mospërputhshmërisë nga operatori i biznesit ushqimor.
3. Përbën shkelje të rëndë sipas pikës 3 të këtij neni, nëse operatori i biznesit ushqimor vendos në treg ushqim i cili është vërtetuar, sipas dispozitave të këtij ligji, se ka shkaktuar dëm në shëndetin e njeriut apo mund të përbente rrezik potencial për jetën e tij.
4. AKU nuk do t’u bëjë të njohur palëve të treta informacionin konfidencial që merr për secilin

trajtim konfidencial të kërkuar dhe justifikuar, me përjashtim të informacionit i cili duhet të bëhet publik nëqoftëse e kërkojnë kushtet, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të konsumatorit.

Neni 22

Pas nenit 43/1 shtohet neni 43/2 me këtë përmbajtje:

“Neni 43/2

Masat e posaçme për trajtimin e ushqimit të pasigurtë

1. Nëse vlerësohet se ushqimi apo ushqimi për kafshë nuk plotëson kërkesat e sigurisë dhe higjienës sipas këtij ligji, AKU vendos:
 - a) ndalimin e prodhimit të mëtejshëm;
 - b) ndalimin e vendosjes në treg të një partie ushqimi të importuar ose eksportin e saj;
 - c) tërheqjen nga tregu si dhe informimin e konsumatorit, nëse një parti ushqimi apo ushqimi për kafshë e cila nuk i plotëson kërkesat e sigurisë dhe higjienës është vendosur në treg.
2. Ushqimi që nuk plotëson kërkesat e sigurisë dhe higjienës sipas legjislacionit, bllokohet dhe sipas rastit AKU vendos:
 - a) asgjësimin;
 - b) autorizimin e nënshtrimit të një trajtimi të posaçëm që e bën ushqimin të sigurt dhe të përshtatshëm për përdorim sipas qëllimit fillestar;
 - c) autorizimin e përdorimit për qëllime të tjera duke përjashtuar qëllimin fillestar.
3. Masat e përcaktuara në shkronjën “b” të pikës 1 dhe 2 të këtij neni zbatohen nga operatori përgjegjës nën mbikqyrjen e AKU-së.
4. Asgjësimi sipas pikës 2 të këtij neni, bëhet në kushte të posaçme që sigurojnë mbrojtjen e shëndetit të njerëzve, shëndetit dhe mirëqënies së kafshëve dhe mbrojtjen e mjedisit. Procedurat dhe kushtet e detajuara të procesit të asgjësimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 23

Pas nenit 43/2 shtohet neni 43/3 me këtë përmbajtje:

“Neni 43/3

Plani i monitorimit të mbetjeve

1. Mbetja e produkteve të mbrojtjes së bimëve në produktet me origjinë bimore të jetë brenda kufijve maksimalë të lejuar të tyre në ushqimet me origjinë bimore.
2. Qumështi lëndë e parë të plotësoj standardin e përmbajtjes së mikroflorës së përgjithshme dhe të përmbajtjes së qelizave somatike.
3. Plani Kombëtar i Monitorimit të Mbetjeve në Produktet me origjinë bimore dhe Plani Kombëtar i Monitorimit të qumështit lëndë e parë miratohen me urdhër të ministrit.

Neni 24

Në nenin 45 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, gërma c) shfuqizohet.
 2. Pika 4 ndryshon si më poshtë:
- “4. Laboratorët e autorizuar të kontrollit akreditoohen nga organizmi kombëtar i akreditimit.”

Neni 25

Në nenin 46 bëhen këto ndryshime:

1. Në fillim të pikës 1 shtohet fjalia “Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë në varësi të ministrit është qendër kërkimore shkencore në fushën e ushqimit dhe ushqimit për kafshë dhe financohet nga buxheti i shtetit.”
2. Pika 2 ndryshon si më poshtë:
“2. Laboratorët e referencës akreditoohen nga organizmi kombëtar i akreditimit.”
3. Pas pikës 3 shtohet pika 3.1 si më poshtë:
“3.1. Ministri mund të përcaktojë si laborator reference edhe laboratorë të tjerë të akredituar, jashtë Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë. Fusha e testeve të laboratorëve të referencës dhe të kontrollit për të cilën ato autorizohen duhet të përfshihet në fushën e akreditimit”
4. Pika 3 gërma “a” ndryshon si më poshtë:
“të bëjnë vlerësimin e laboratorëve në lidhje me kushtet e shërbimit të ofruar prej tyre për kryerjen e analizave, të kontroleve zyrtare, vlerësim i cili shërben për pajisjen e tyre me autorizim nga Ministri”.
5. Pika 3 gërma ç) shfuqizohet.
6. Pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:
“5. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të ISUV përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave me propozim të ministrit.”

Neni 26

Neni 47 ndryshohet si vijon:

Neni 47

Plani i përgjithshëm për menaxhimin e krizave

1. Menaxhimi i krizave bëhet në bazë të një plani të përgjithshëm për trajtimin e krizave në fushën e sigurisë ushqimore.
2. Plani i përgjithshëm për trajtimin e krizave në fushën e sigurisë ushqimore miratohet me urdhër të Ministrit dhe përcakton:
 - a) llojet e riskut me origjinë ushqimore të cilat mund të rrezikojnë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, shëndetin e njerëzve dhe që nuk mund të parandalohen, eliminohen apo reduktohen deri në një nivel të pranueshëm, nëpërmjet zbatimit të dispozitave, të parashikuara në këtë ligj;

- b) procedurat praktike thelbësore për trajtimin e një krize;
- c) ngritjen e një njësie për menaxhimin e krizave pranë Ministrisë;
- d) strategjinë e komunikimit në rastet e krizave ndërmjet Ministrisë dhe institucioneve të tjera përgjegjëse, konsumatorit dhe operatorëve të biznesit të ushqimit dhe të ushqimit për kafshë.

Neni 27

Neni 48 ndryshohet si vijon:

“Neni 48

Masa të përgjithshme për garantimin e sigurisë ushqimore

1. Kur çmohet se një ushqim apo ushqim për kafshë paraqet një rrezik serioz për shëndetin e njerëzve, shëndetin e kafshëve apo për mjedisin dhe se një rrezik i tillë nuk mund të parandalohet, reduktohet apo eliminohet, në varësi të shkallës së rëndësisë së gjendjes, Ministri urdhëron marrjen e masave të përgjithshme, sipas pikave 2 dhe 3 të këtij neni.
2. Në rastin e ushqimit të prodhuar në vend, mund të merren këto masa:
 - a) ndalimi i përkohshëm i hedhjes në treg ose i përdorimit të një ushqimi;
 - b) përcaktimi i kushteve të veçanta për hedhjen në treg të një ushqimi të caktuar;
 - c) asgjësimi i ushqimeve, pa shkaktuar dëme sipas pikës 5 të nenit 43/2;
 - ç) çdo masë tjetër të përkohshme dhe proporcionale.
3. Në rastin e ushqimit nga importi, mund të merren këto masa:
 - a) ndalimi i përkohshëm i importit të ushqimit nga vendet eksportuese ose nga pjesë të vendit eksportues ose të vendeve tranzit;
 - b) përcaktimi i masave të veçanta për ushqime specifike nga vendet eksportuese, pjesë të vendeve eksportuese ose nga vendet tranzit;
 - c) asgjësimin e ushqimeve pa shkaktuar dëme sipas pikës 5 të nenit 43/2;
 - ç) çdo masë tjetër të përkohshme dhe proporcionale.”

Neni 28

Në nenin 50 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 2, pas shkronjës dh) shtohet shkronja e) me këtë përmbajtje:

“e) aditivët në ushqimin për kafshë, ushqimin e përbërë për kafshë, materialet e ushqimit për kafshë, substanca të padëshirueshme, ushqim për kafshë i përcaktuar për qëllime ushqimore të veçanta, produkte të caktuara të përdorura si vlera ushqimore për kafshë (bioproteinat), ushqim i trajtuar me medikamente.”

2. Pas pikës 2 shtohet pika 3 si më poshtë:

“3. Dispozitat e nenit 11 të këtij ligji, zbatohen edhe për përcaktimin e kritereve të sigurisë të ushqimeve për kafshë.”

Neni 29

Neni 51 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 51

Importi, eksporti dhe kontrolli i ushqimit për kafshë

Nenet 14, 15, 16 dhe 18 të këtij ligji zbatohen edhe për importin, eksportin dhe kontrollin e ushqimit për kafshë në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 30

Neni 57 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 57

Kontrolli zyrtar i ushqimit për kafshë

Dispozitat e neneve 38, 40, 41 , 43/1 dhe 43/2 të këtij ligji zbatohen edhe për kontrollin zyrtar të ushqimit për kafshë.”

Neni 31

Neni 58 shfuqizohet.

Neni 32

Neni 59 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 59

Laboratorët e autorizuar të kontrollit dhe të referencës

Dispozitat e neneve 44, 45 dhe 46 të këtij ligji zbatohen edhe për laboratorët e autorizuar të kontrollit dhe të referencës të ushqimit për kafshë.”

Neni 33

Në nenin 61, pika 3 dhe 6 shfuqizohen.

Neni 34

Neni 62 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 62

Fusha e veprimtarisë së AKU-së

1. AKU-ja është organi shtetëror kompetent për kryerjen e kontrollit zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë në përputhje me këtë ligj. Ajo kryen detyra të tjera në lidhje me shëndetin dhe mirëqënien e kafshëve si dhe të mbrojtjes së bimëve në përputhje me ligjet respektive specifike.
2. Në kuadër të vlerësimit të riskut, AKU-ja kryen veprimtaritë e mëposhtme në mbështetje të Komitetit Shkencor dhe paneleve shkencore:

a) kërkon, grumbullon dhe analizon informacionin teknik për karakterizimin dhe monitorimin e riskut, i cili ka ndikim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mbi sigurinë e ushqimit dhe të ushqimit për kafshë;

b) bashkëpunon me Institucione të tjera dhe me persona të tjerë juridikë për monitorimin e sigurisë së ushqimit dhe të ushqimit për kafshë;

c) kryen veprimtari për identifikimin dhe karakterizimin e riskut për sigurinë e ushqimit dhe të ushqimit për kafshë;

d) vendos mënyra të njehsuara të vlerësimit të riskut në të gjitha nivelet e prodhimit, të përpunimit dhe shpërndarjes së ushqimit e të ushqimit për kafshë.

3. Në kuadër të komunikimit të riskut, AKU-ja ka në mënyrë të veçantë këto përgjegjësi:

a) informon mbi riskun dhe jep mendimin teknik për Ministrinë, rast pas rasti mbi rreziqet dhe mbi sigurinë e ushqimit dhe të ushqimit për kafshë;

b) krijon një sistem informimi të shpejtë dhe për këtë qëllim, merr e dërgon të gjithë informacionin për rreziqet e ushqimit, si dhe krijon një sistem qendror për shkëmbimin e informacionit.

4. Në kuadër të menaxhimit të riskut, AKU-ja bashkëpunon me Ministrinë për bashkërendimin e veprimtarive të përcaktuara në pikën 2 gërma b) të nenit 6 të këtij ligji.

5. AKU-ja gjithashtu kryen këto funksione:

a) përgatit materiale informuese për praktikatat e mira të prodhimit bujqësor, praktikatat e mira të përpunimit, praktikatat e mira të higjienës, për aplikimin e sistemit HACCP dhe për praktikatat e mira laboratorike;

b) bashkëpunon me institucione dhe organizma ndërkombëtare që trajtojnë çështjet e sigurisë ushqimore;

c) ushtron çdo funksion tjetër shtetëror të përcaktuar nga Këshilli i Ministrave në bazë të legjislacionit në fuqi.

6. Një apo disa funksione të AKU-së lidhur me kontrollin zyrtar mund t'i delegohen një institucioni tjetër shtetëror në përputhje me Kodin e Procedurës Administrative.

7. Veprimtaritë, metodat dhe teknikat për kontrollin zyrtar kryen sipas parashikimeve të bëra në këtë ligj.

8. Inspektorët e AKU-së gëzojnë statusin e inspektorit sipas Ligjit për Inspektimin.”

Neni 35

Neni 63 shfuqizohet.

Neni 36

Neni 64, ndryshohet si më poshtë:

“Neni 64

Stuktura, mandati dhe detyrat e bordit

“1. Bordi është përgjegjës për të siguruar që AKU-ja kryen misionin dhe përmbush detyrat e ngarkuara nga ky ligj. Bordi miraton:

- a) rregulloren e brendshme të funksionimit të AKU-së, që i paraqitet ministrit për miratim;
- b) objektivat strategjike dhe planet e punës të AKU-së;
- c) projektbuxhetin e AKU-së, që i paraqitet Ministrit;
- ç) raportin vjetor të vlerësimit të veprimtarisë së AKU-së;
- d) kërkesat e posaçme të vendeve të punës për rekrutimin e punonjësve të AKU-së;
- dh) projektplanin e menaxhimit të krizave, të propozuar nga AKU-ja.

Bordi përbëhet nga 9 antarë si më poshtë:

- a) tre përfaqësues nga ministria përgjegjëse për bujqësinë;
- b) një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë;
- c) një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për financat;
- ç) një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për rendin dhe sigurinë;
- d) Drejtori i Përgjithshëm i AKU-së;
- e) dy profesorë në fushën e ushqimit dhe ushqimit për kafshë.

2. Kushtet që duhet të plotësojnë anëtarët e Bordit të përcaktuar në shkronjat a, b, c, ç, funksionet, kriteret e emërimit dhe të shkarkimit, mënyra e funksionimit, të drejtat dhe detyrat dhe mënyra e trajtimit financiar si dhe emërimi i antarëve sipas shkronjës “e” të pikës 1, pëcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit.

3. Anëtarët e bordit, përfaqësues të ministrive, duhet të jenë punonjës në ministrinë përkatëse dhe emrat e tyre i propozohen ministrit nga ministri përkatës. Përbërja e Bordit miratohet me urdhër të ministrit.

4. Anëtarët e bordit zgjidhen për një mandat 4-vjeçar.

5. Kryetari i bordit propozohet nga anëtarët e bordit dhe emërohet nga Ministri përgjegjës për bujqësinë, për një periudhë dyvjeçare.”

Neni 37

Neni 66 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 66

Komiteti Shkencor i Vlerësimit të Riskut dhe panelet shkencore

1. Komiteti Shkencor i Vlerësimit të Riskut dhe Panelet Shkencore kanë në përbërje ekspertë të fushës akademike. Komiteti Shkencor i Vlerësimit të Riskut dhe Panelet Shkencore janë ad hoc të pavarur nga ministria apo institucione të tjera. Anëtarët dhe kryetari i paneleve shkencore caktohen nga Ministri. Kryetarët e paneleve shkencore përbëjnë Komitetin Shkencor të Vlerësimit të Riskut.
2. Komiteti Shkencor i Vlerësimit të Riskut dhe panelet shkencore japin mendim shkencor për vlerësimin e riskut.

3. Komiteti Shkencor i Vlerësimit të Riskut jep mendime shkencore me kërkesë të Ministrit apo me nismën e tij. Mendimi shkencor jepet brenda periudhës së përcaktuar në kërkesën e Ministrit me përjashtim të rastit kur për rrethana objektive kjo nuk është e mundur.
4. Kërkesa e paraqitur nga Ministri, sipas pikës 3 të këtij neni shoqërohet me të gjithë informacionin e nevojshëm, dhe përcakton çështje shkencore për të cilën kërkohet mendim.
5. Komiteti Shkencor i Vlerësimit të Riskut mund të refuzojë kërkesën, të propozojë që kërkesa të ndryshohet apo të kërkojë informacione shtesë, kur:
 - a) është paraqitur më shumë se një kërkesë për të njëjtën çështje shkencore;
 - b) kërkesa për dhënien e mendimit shkencor nuk shoqërohet me informacionin e nevojshëm apo gjykohet e paqartë;
 - c) Komiteti Shkencor i Vlerësimit të Riskut ka dhënë më parë mendimin e tij për çështjen shkencore për të cilën kërkohet mendim dhe çmon se nuk ka informacione të reja që duhen vlerësuar.
6. Numri i paneleve shkencore përcaktohet me udhëzim të ministrit. Përbërja, funksionimi, mënyra e caktimit dhe e shkarkimit, pagesa e anëtarëve si dhe të drejtat dhe detyrat e Komitetit Shkencor të Vlerësimit të Riskut dhe të paneleve shkencore përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave me propozim të Ministrit.”

Neni 38

Në fund të nenit 72 shtohen pika 6 me këtë përmbajtje:

“6. Detyrimi i akreditimit, sipas përcaktimit të pikës 4 të nenit 45 të këtij ligj bëhet i zbatueshëm 5 vjet pas hyrjes në fuqi të këtij ndryshimi.”

Neni 39

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

KRYETARI

GRAMOZ RUÇI